- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykatë apo arbitrim.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 615-24-7579-5-1-1/C1066

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 114,079.00 euro me vlefshmëri prej 447 ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës,
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës....
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik e që është 300 ditë.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [shëno numrin] ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është do të caktohet nga ZKA brenda 5 ditësh
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

TREGU / B+P+1

LOKACIONI: PODUJEVE

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL PODUJEVE

VËREJTJE:

Gjatë realizimit të pozicioneve të kësaj paramase duhet referuar edhe: Përshkrimi Teknik, Projekti, Detajet, Skemat grafike dhe Specifikimet Teknike. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punën, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale (të kompletuar), garancinë, prezentimin e certifikatave për produktet dhe certifikatave të prodhuesve me standarde ISO ose standarde të cilat janë të cekura në përshkrim teknik apo paramase si dhe të prodhohen në përputhje me EC-standartet. Çmimi duhet të përfshijë gjithashtu të gjitha materialet shpenzuese deri në vuarjen në punë. Llogaritja e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të pozicioneve. Të dhënat teknike, dimensionet, sasi të, etj, nëpërmjet kësaj kontrate duhet të jenë me ISU - Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (International System of Units). Të gjitha produktet e propozuara duhet të shoqërohen me një certifikatë cilësie të prodhuesit dhe të miratuar paraprakisht nga mbikëqyrësi. Në rast mospërputhjeje midis të dhënave në paramase dhe Përshkrimi Teknik, ku përshkrimi teknik gjithmonë duhet të merret i pari, duke përjashtuar rastet e gabimeve teknike eventuale ku metoda më e favorshme është se duhet miratuar zgjidhja. Nëse për shkak të neglizhencës në punë shkaktohet dëmtim në zonën përreth kantierit dhe brenda kantierit, atëherë përgjegjësia për rregullimin i takon kontraktorit. Materiali i demoluar, mbeturina, dheu etj që nuk ka ndonjë vlerë konsiderohet pronë e pronarit dhe pronari do të japë udhëzime për asgjësimin apo deponimin e materialit të demoluar, ndërsa demolimi dhe transporti janë përgjegjësi e kontraktorit. Çmimi për skelerë duhet të përfshihet në çdo pozicion ku nevojiten për përfundimin e punimeve apo realizimin e atij pozicioni. Çmimet duhet të përfshijnë çdo aktivitet tjetër që nuk përshkruhet këtu, por që është i nevojshëm për përfundimin e punimeve apo realizimin e pozicionit. Kontraktori është i detyruar të bëjë matjet e të gjitha pozicioneve, para fillimit të prodhimit dhe furnizimit.

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtës me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrit e caktuar të punishtës dhe shënjestëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	komplet	1	1,640.00 €	1,640.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtës dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	1,640.00 €	1,640.00 €
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjestëzimi i objektit për ndërtim dhe gjatë ndërtimit.	komplet	1	985.00 €	985.00 €
1.01.04	Pergaditja e punishtës për fillimin e punimeve e cila përfshinë: Pastrimi i përgjithshëm i terrenit e komplet siperfaqen e parcelles e cila ka siperfaqe S=1600 m², demolimi i pllatoeve nga asfalti apo betoni, demolimi, skajoreve, kubezave, kanaleve nga betoni, murit rrethues të parcelles dhe largimi i instalimeve mbetokësore dhe nentokësore, laurave, etj. Demolimi/rrënim i objektit ekzistues P+0 me siperfaqe S=200 m² me themele nga konstruksioni i betonit dhe pjesa tjetër nga konstruksioni i drurit, rrënim i objektit të behet pas largimit të inventarit që ndodhet brenda tij. Demolimi dhe dislokimi i instalimeve me të cilat është i lidhur objekti. Verejtje: Në këtë pozicion përfshihen të gjitha punët për pastrimin e parcelles deri të pergaditja e parcelles për fillimin e punimeve (germimit). Transporti i mbeturinave deri në deponi e cila përcaktohet nga ana e Autoritetit Kontraktues.	komplet	1	11,800.00 €	11,800.00 €
TOTAL POZICIONI				1.01	16,065.00 €

1.02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA

1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi 30 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m ³	360.00	2.90 €	1,044.00 €
1.02.02	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë për hapjen e bodrumit të objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	3,600.00	2.90 €	10,440.00 €
1.02.03	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë për hapjen për themelet pllake të objektit dhe gropën e berthamës së ashensorit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	1,400.00	3.50 €	4,900.00 €
1.02.04	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë mureve perimetrike të bodrumit, rreth berthamës së ashensorit, si dhe punimi i tamponit nga zhavori nën pllakën e themelit me trashësi 40 cm me fraksion 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë MS=40 MPa.	m ³	1,100.00	18.50 €	20,350.00 €
1.02.05					0.00 €
1.02.06					0.00 €
1.02.07					0.00 €
1.02.08					0.00 €
1.02.09					0.00 €
1.02.10					0.00 €
TOTAL POZICIONI			1.02		36,734.00 €

1.03 PUNËT E BETONIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. VËREJTJE 2: Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikqyrës.				
1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e shtresës së hidroizolimit. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e pllakes së themelit.	m ³	75.00	64.00 €	4,800.00 €
1.03.02	Furnizimi me material dhe punimi i bazës në tere sipërfaqen e objektit mbi shtresën e hidroizolimit për mbrojtjen e tij gjatë punimit të pozicionit vijues. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e pllakes së themelit.	m ³	75.00	64.00 €	4,800.00 €

1.03.03	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i themelit pllake me trashësi 45 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Punimi i dyshemese te behet me FER beton. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	640.00	96.00 €	61,440.00 €
1.03.04	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i mureve perimetrike të bodrumit me trashësi 25 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Tek muret e themelit betoni duhet të jetë beton I natyralizuar I cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të mureve të jenë të pastërta. Pahlitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike, pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.	m ³	98.00	96.00 €	9,408.00 €
1.03.05	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave si dhe mureve nga betoni i armuar duke përfshirë muret e rampes si dhe bërthamën e ashensorit në nivelin e bodrumit, përdhësës dhe katit 1. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. Muret perimetrike te bodrumit te punohen me kallepe/pahi speciale ngase betoni duhet te mbetet beton i natyralizuar, i paster dhe nuk suvatohet. VËREJTJE: Para betonimit duhet të verifikohen dimensionet dhe pozita e hapjes për dyert e ashensorit varësisht nga specifikat e tipit/markës së ashensorit të propozuar/aprovuar. Tek muret e themelit betoni duhet të jetë beton I natyralizuar I cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të mureve të jenë të pastërta. Pahlitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike, pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.	m ³	105.00	96.00 €	10,080.00 €
1.03.06	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakes se perdheses me trashësi 25 cm, trarët perimetrik, konzollat e strehëve me përfundimet e tyre të lëshuara në të gjitha anët e përcaktuara me projekt duke përfshihet edhe betonimin e shkallëve të brendshme dhe betonimin e rampes. Ne pllaken e perdheses te përfshihet edhe trau perimetrik tek pjesa e tregut me dimensione (50x15cm) si dhe trau(muri) me dimensione (20x15cm) ne perimeter te pllakes ne te cilin do te mbeshtetet gardhi metalik. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Gjatë betonimit të pllakave duhet ti kushtohet kujdes dimensioneve të hapjes së ashensorit, hapjes së rampes, trajeve perimetrike te tregut dhe parcelles si dhe përfundimit në nivelin e fundit.	m ³	370.00	96.00 €	35,520.00 €

1.03.07	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakes se katit dhe pllakes se kulmit me trashësi 20 cm, trarët perimetrik, konzollat e strehëve me përfundimet e tyre të lëshuara në të gjitha anët e përcaktuara me projekt duke përfshihet edhe betonimin e shkallëve të brendshme. Ne pllaken e kulmit te perfshihen muret e ashensorit mbi pllaken e kulmit dhe pllaka e mbuleses se ashensorit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Gjatë betonimit të pllakave duhet ti kushtohet kujdes dimensioneve të hapjes së ashensorit, gabaritit dhe përfundimit në nivelin e fundit.	m ³	95.00	96.00 €	9,120.00 €
1.03.08	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i cerklazhit me trashësi 20 cm mbi murin e atikës mbi pllaken e kulmit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	10.70	96.00 €	1,027.20 €
1.03.09	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer) me dimensione 12x20 15x20 25x20 cm si dhe i cerklazhit mbi muret e terasës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	4.00	96.00 €	384.00 €
TOTAL POZICIONI			1.03	136,579.20 €	

1.04 PUNËT E ARMIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
1.04.01	Ø 8, Ø10, Ø12, Ø14, Ø16, Ø20	kg	190,000.00	0.95 €	180,500.00 €
TOTAL POZICIONI					180,500.00 €

1.05 PUNËT E GERMIMIT, ARMIMIT DHE BETONIMIT TE PILOTAVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.05.01	Gërmimi i dheut me makineri për hapjen e vrimave (gropave) për punimin e pilotave ne perimeter te parcelles. . Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Punimi i pilotave te behet sipas detaleve ne projekt. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	375.00	12.50 €	4,687.50 €
1.05.02	Furnizimi me material dhe betonimi i pilotave ne perimeter te parcelles sipas projektit me dimensione D=60cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37. Punimi i pilotave te behet sipas detaleve ne projekt. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	375.00	100.00 €	37,500.00 €
1.05.03	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i traut perimetrik (lidhes) qe lidhe pilotat me dimensione b/h=60/50cm sipas detaleve ne projektet me beton të markës c-30/37. Punimi i pilotave te behet sipas detaleve ne projekt. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	50.00	100.00 €	5,000.00 €
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				

1.05.04	Ø10, Ø12, Ø16, Ø20	kg	67,000.00	0.95 €	63,650.00 €
TOTAL POZICIONI					110,837.50 €

1.06	PUNËT E MURATIMIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
1.06.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12, 20, 25 me bloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m ³	230.00	68.00 €	15,640.00 €
TOTAL POZICIONI				1.06	15,640.00 €

1.07	PUNËT E SUVATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.07.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e pllakës meskatëshe në të gjitha kthinat në bodrum, përdhese dhe katin e parë si dhe suvatimi i plafoneve në kthinat me material/llaq të parapërzier (gëlqere+çimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaq sprucues ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rjetë armimi dhe shirit vetngjithës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folie të PVC-së si dhe rjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaqit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si bloqe-beton.	m ²	2,300.00	6.60 €	15,180.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe finalizimi i mureve dhe plafonit të depove në bodrum dhe depove sanitare në përdhese dhe kat me llaq finalizues të hollë të parapërzier me strukturë (gëlqere + çimento + agregat i imët).	m ²	900.00	2.80 €	2,520.00 €
1.07.03	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa glet-masë në të gjitha kthinat në nivelin e përdhësës dhe katit 1 të përcaktuara me projekt.	m ²	1,100.00	2.80 €	3,080.00 €
TOTAL POZICIONI				1.07	20,780.00 €

1.08	PUNËT E NGJYROSJES				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.08.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të patinuara me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	1,450.00	2.45 €	3,552.50 €
1.08.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e plafoneve të suvatuara me llaq me strukturë me dy shtresa ngjyrë. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	550.00	2.45 €	1,347.50 €
TOTAL POZICIONI				1.08	4,900.00 €

1.09	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMËSË				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.09.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha kthinat e brendshme me dyshe me pllakat qeramike duke përfshirë shtresat termoizoluese dhe zëizoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrih t=4-6 cm • Termoizolim EPS® A100 t=3 cm • Termoizolim EPS® T650 t= 5 cm	m ²	470.00	18.10 €	8,507.00 €

1.09.02	Furnizimi me material dhe punimi i betonit me ramje mbi pllaken e perdhese tek pjesa e tregut ne kuoten $\pm 0.00m$, me ramje në drejtim të ujëmbledhësve sipas projektit. Në çmim të përfshihet realizimi i shtresave në vijim: • Beton me ramje t= prej 5-12 cm si dhe finalizimi me shtrese ferobeton • Folie PE • Termoizolim i dhëmbëzuar XPS@ 30 t=8 cm Verëjtje: Betoni qe do te perdoret ne kete pozicion duhet te jete me beton me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos.	m ²	370.00	23.00 €	8,510.00 €
1.09.03	Furnizimi me material dhe punimi i mureve perimetrike te bodrumit. Muri perimetrike duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë • Ngjitës - masë hidroizoluese • Termoizolim XPS 30 t=3 cm • Hidroizolim Sikaplan 14.6 (mbivendosja e shtresave është 30 cm) • Termoizolim XPS 30 t=5 cm • Foli PVC (fundoline) Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet e nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese etj për fiksimin dhe sigurimin e plotë të cokllës.	m ²	520.00	40.00 €	20,800.00 €
1.09.04	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit të pushimoreve dhe të shkallëve të brendshme, Në çmim të llogaritet nivelizimi me: • Estrih t=6 cm	m ²	32.00	18.00 €	576.00 €
TOTAL POZICIONI			1.09	38,393.00 €	

1.1	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.10.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi nen themelin pllake me shtresat si në vijim: • Shtresa mbrojtëse nga betoni i varfer.(i parapare me heret) • Gjeotekstil 500gr/m² • Hidroizolim Sikaplan 14.6 • Gjeotekstil 500gr/m² • Beton i varfer per nivelizim 5cm.(i parapare me heret) Verëjtje: Mbivendosja e shtresave duhet te jete me e madhe se 30 cm. Hidroizolimi Sikaplan 14.6 te parashihet edhe te kthehet ne perimeter ne lartesi ~30cm.	m ²	1,450.00	23.00 €	33,350.00 €
1.10.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi mbi pllaken e perdhese(pjesa e pllatoze) me shtresat si në vijim: • Pastrimi sipërfaqes se pllakes,largimi i pjeseve te thepisura gjate betonimit ,trajtimi i sipërfaqes ne menyre qe te mos vije deri tek demtimi i hidroizolimit. • Hidroizolim Sikaplan 14.6 • Gjeotekstil 500gr/m² • Shtresa e zhavorit 0 - 4 mm me trashësi 10 cm(parapre ne pozicionin e pllakave te gurit) Verëjtje: Mbivendosja e shtresave duhet te jete me e madhe se 30 cm. Hidroizolimi Sikaplan 14.6 te parashihet edhe te kthehet ne perimeter ne lartesi ~30cm.	m ²	745.00	23.00 €	17,135.00 €

1.10.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi mbi pllaken e perdheses(pjesa e tregut) me shtresat si në vijim: • Pastrimi sipërfaqes së pllakes,largimi i pjeseve te thepisura gjate betonimit ,trajtimi i sipërfaqes ne menyre qe te mos vije deri tek demtimi i hidroizolimit. • Hidroizolim Sikaplan 14.6 • Termoizolim XPS 8 cm(parapare ne pozicionin e nivelizmit) Verjetje: Mbivendosja e shtresave duhet te jete me e madhe se 30 cm. Hidroizolimi Sikaplan 14.6 te parashihet edhe te kthehet ne perimeter ne lartesi ~30cm.	m ²	410.00	23.00 €	9,430.00 €
1.10.02	Furnizimi me material dhe hidroizolimi mbi pllakën e perdheses tek pjesa e lokaleve(lokal,nyje sanitare,depo) dhe mbi pllakën e katit pjesa e terases , me një lyerje të ftohtë (bitulit) dhe me dy shtresa me t=4mm (dmth 4mm+4mm). Ngjitja bëhet me flakë, kurse kalimi i shtresave është 15 cm. Verejtje: Tek pjesa ku do te kete hapje(vrima) ne pllake per shkak te instalimeve te behet gjithashtu edhe trajtimi i tyre.	m ²	330.00	23.00 €	7,590.00 €
1.10.03	Furnizimi me material dhe hidroizolim te lokale dhe te nyjeve sanitare në përdhese & katin e parë, dhe terasës në katin e parë. Në çmim duhet përfshirë hidroizolim dhe dyshemesë në këto hapësira si dhe hidroizolim e mureve perimetrike deri në lartësi 30 cm me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh të aplikuar në dy shtresa sipas udhëzimeve të prodhuesit. Poashtu në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rrjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasaritjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	390.00	18.00 €	7,020.00 €
1.10.04	Furnizimi me material dhe ngjitja e shiritit ekspandues nga sodium bentoniti me dimensione 1.5x2.0 cm si Waterstop 1520 i cili në kontakt me ujin e zmadhon volumin deri në 270% dhe përballon shtypje deri në 5 atmosfera. Shiriti duhet të vendoset në këto pozicione: • Në mes të themelit të ashensorit dhe mureve perimetrike te ashensorit, • Në mes të mureve te ashensorit dhe themelpillakes, • Në mes të mureve perimetrike dhe pllakës së themelit, • Në mes të mureve të rampes dhe pllakës së themelit Të gjitha këto për sigurimin e padepërtueshmërisë së ujërave nëntokësor. Vendosja dhe vazhdimi i shiritave të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	m ^l	170.00	19.60 €	3,332.00 €
TOTAL POZICIONI			1.10	77,857.00 €	

1.11	PUNËT E QERAMIKËS PORCELANIT GRANITIT KUARCIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA

1.11.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së kthinave te lokaleve, koridorit, depove sanitare, terrases dhe kthines se mirembajtjes me pllaka të paglazura porcelani me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjidhen në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ²	365.00	19.60 €	7,154.00 €
1.11.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës për mirëmbajtje më të lehtë të kthinave te lokaleve, depove sanitare, terrases dhe kthines se mirembajtjes të cilat janë të shtruara me pllaka porcelani. Coklla të punohet me pllaka të glazuara porcelani me lartësi 10 cm, me ngjyrë dhe teksturë/dizajn të njëjtë si ato të dyshemesë. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ^l	256.00	4.90 €	1,254.40 €
1.11.03	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë tek nyjet sanitare në të dy nivelet me pllaka të paglazura qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjidhen në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ²	44.00	18.00 €	792.00 €
1.11.04	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve deri në lartësinë e pllakës meskatëshe (h=340 cm) tek nyjet sanitare me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m ²	315.00	14.75 €	4,646.25 €

1.11.05	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme duke përfshirë pushimoren, basamakët (shkelëset dhe balloret), cokllën e shkallëzuar rreth mureve dhe shkallën e fundit në tërë gjerësinë e kafazit të shkallëve. Të gjitha sipërfaqet të vishen me pllaka të poliruara graniti me trashësi 2 cm (balloret dhe coklla 2 cm). Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	32.00	90.00 €	2,880.00 €
1.11.06	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti aty ku është e mundur të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdime). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm Gjerësia 25 cm (3 cm duhet të dalin jashtë murit) Ngjyra e bardhë	m ^l	7.00	23.00 €	161.00 €
TOTAL POZICIONI			1.11	16,887.65 €	

1.12	PUNËT E ZDRUKHTARISË DYERT, DRITARET DHE ELEMENTET TJERA				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.12.01	Furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve të punuara nga profilet e aluminit sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë të gjitha mjetet e lidhjes dhe fiksimit dhe shumën montuese nga PU. DRITARET Korniza fikse: M11010 62.5x58 mm ose M11014 62.5x68 cm opcionale Krahu i dritares: M11434 70.0x75 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90 mm Profili lëvizës T: M11058 Listella e kornizës: M11439 Listella e krahut: M15110 DYERT tipologjia me hapje brenda Korniza fikse: M11086 67.7x68.0 mm Krahu i derës: M11082 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11156 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11453 Listella e krahut: M11453 Pragu i ulët: M11184 DYERT tipologjia me hapje jashtë Korniza fikse: M11088 62.5x68.0 mm Krahu i derës: M11084 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11158 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11084 Listella e krahut: M11453 Pragu i ulët: M11184 Qelqi: Transparent Termopan 4+16+4mm/Low-E + Argon (sipas skemave të zdrukthtarisë) Qelqi: Transparent Lameluar (3+3)+12+(3+3)mm/Low-E + Argon (sipas skemave të zdrukthtarisë) Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje Punimi i pragut të aluminit me lartësi min.17.5mm. Profili nga alumini horizontal me ramje për largimin e ujrave në pjesën e poshtme të profilit të dyerve dhe dritareve. EPS t=24 mm E hirtë Anodised - RAL 7016 Ngjyra e profileve: E hirtë Anodised - RAL 7016 Izolimi akustik: 47 dB UF=2.3 W/m²K VËREJTJE: Të gjitha profilet e dyerve dhe dritareve pas montimit dhe ngurtësimit të shumës montuese duhet të largohen shiritat				
a.	POS D1 Derë e brendshme njëkrahëshe. Të gjitha mbushjet me panel termoizolues. Dimensionet: 80x210 cm Dukja si në skemë	copë	22	275.00 €	6,050.00 €

b.	POS D2 Derë e brendshme njekrahëshe. Të gjitha mbushjet me panel termoizolues. Dimensionet: 100x210 cm Dukja si në skemë	copë	3	340.00 €	1,020.00 €
c.	POS D3 Derë e jashtme njekrahëshe me xham. Të gjitha mbushjet me qelq termopan. Dimensionet: 80x210 cm Dukja si në skemë	copë	1	265.00 €	265.00 €
d.	POS D4 Derë e jashtme njekrahëshe me xham e mbindricim me anesore fikse. Të gjitha mbushjet me qelq te Lameluar (3+3)+12+(3+3). Dimensionet: 260x305 cm Dukja si në skemë	copë	5	1,360.00 €	6,800.00 €
e.	POS D5 Derë e jashtme njekrahëshe me xham. Të gjitha mbushjet me qelq termopan. Dimensionet: 100x210 cm Dukja si në skemë	copë	4	340.00 €	1,360.00 €
f.	POS W1 Dritare dykrahëshe statike. Të gjitha mbushjet me qelq te Lameluar (3+3)+12+(3+3). Dimensionet: 260x305 cm Dukja si në skemë	copë	11	1,360.00 €	14,960.00 €
g.	POS W2 Dritare njekrahëshe l hapja rreth aksit vertikal & horizontal. Mbushja me qelq termopan. Dimensionet: 80x60 cm Dukja si në skemë	copë	8	90.00 €	720.00 €
h.	POS W3 Dritare njekrahëshe statike. Të gjitha mbushjet me qelq te Lameluar (3+3)+12+(3+3). Dimensionet: 130x305 cm Dukja si në skemë	copë	2	680.60 €	1,361.20 €
i.	POS F1 Furnizimi dhe montimi i fasades gjysemstrukturale anesore Profili ALUMIL - SMARTIA M7 (me nderprerje termike), Prodhuesi: ALUMIL Ngjyrë Antracid. XHAMI: l Lameluar (3+3)+12+(3+3) , Low-E (kater stinor) me veti te reflektimit te rezeve te diellit, dhe me ruajte te energjise se brendshme, te mbushura me Argon. Gjerësia e ramit dhe krahu i hapjes sipas specifikimit të zdhukthtarisë.	m ²	280	188.00 €	52,640.00 €
